

URDHËR
Nr. 90, datë 3.8.2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 123, DATË
28.7.2021, “PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS PËR NËNSHKRIMIN E
DOKUMENTEVE ADMINISTRATIVE QË DALIN NGA ZYRA E
INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 204, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenit 28 dhe nenit 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr. 123, datë 28.7.2021, “Për delegimin e kompetencës për nënshkrimin e dokumenteve administrative që dalin nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pika 1 e urdhrit, ndryshon si vijon:

“1. Delegimin e kompetencës së nënshkrimit të dokumenteve administrative që dalin nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas fushës së përgjegjësisë që mbulon Drejtoria e Hartimit të Akteve dhe Shërbimeve Juridike, Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria e Analizës dhe Standardeve.”.

b) Në pikën 2 të urdhrit, pas shkronjës “f”, shtohet shkronja “g” me përmbajtjen si vijon:

““g” Nënshkrimin e autorizimeve për përfaqësimin e çështjeve në gjykatë dhe në të gjitha shkallët e gjykimit, në mungesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.”.

2. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTOR I LARTË I DREJTËSISË
Artur Metani